

# OBLIGIMET E KOMUNAVE NGA AGJENDA EVROPIANE 2017

## KOMUNA E PRISHTINËS

<b>Data e dorëzimit të raportit:</b>	30.06.2017				
<b>Emri i komunës</b>	Prishtinë				
<b>Emri i Kryetarit të Komunës</b>	Shpend Ahmeti				
<b>Emri i Zyrtarit Komunal për IE :</b>	Ajshe Bërveniku				
<b>Detajet kontaktuese:</b>	E-mail: <a href="mailto:ajshe.berveniku@rks-gov.net">ajshe.berveniku@rks-gov.net</a> ;				
	Objektivi Strategjik duke u trajtuar	Drejtoritë përgjegjëse komunale	Pyetjet lidhur me zbatimin e aktiviteteve gjatë periudhës së raportimit	Përmbledhja e aktiviteteve të kryera gjatë periudhës së raportimit (Janar – Qershor 2017)	Sfidat për zbatim

### 1. BLOKU I: KRITERET POLITIKE

	<b>1. Administrata publike</b>				
	1.1. Forcimi i kapaciteteve të administratës në nivelin lokal, përfshirë komunat e sapo formuara, duke ofruar udhëzime nga niveli qendror tek ai lokal	<b>Të gjitha Drejtoritë/ Njësitë/ Zyrat dhe Sektorët</b>	<p>1. A është hartuar programi i trajnimeve për komunën tuaj?</p> <p>2. Sa është numri i trajnimeve të mbajtura në komunën tuaj dhe cilat janë fushat e trajnimeve</p> <p>3. Sa është numri i zyrtarëve të komunës që kanë marrë pjesë në trajnime?</p>	<p>1. Nuk është hartuar programi i trajnimeve;</p> <p>2. Sa i përket trajnimeve për nënpunësit e Sektorit të Burimeve Njerëzore janë:</p> <p>1. Metodatat e Testimit në Procesin e Rekrutimit;</p> <p>2. Lidërshipi dhe Menaxhimi;</p>	

	<p>1.2.Të zbatohet legjislacioni dhe politikat për reformën e administratës publike</p>	<p><b>Zyra e personelit</b></p>	<p>1.A është përgatitur Katalogu i vendeve të punës në Shërbimin Civil në komunën tuaj?</p>	<p>1. Po Katalogu është hartuar si dhe janë hartuar aktemërimet në bazë të këtij katalogu;</p>	
	<p>1.3.Të ngritet transparenca e punës dhe vendimmarrjes të nivelit lokal</p>	<p><b>Drejtoria e Administratës</b></p>	<p>1.Sa është numri i kërkesave?  2.A janë publikuar në ueb faqen e komunës tuaj të gjitha aktet dhe dokumentet e nxjerra nga organet e komunave në gjuhët zyrtare?  3. Sa është numri i konsultimeve publike?  4. Sa është numri i takimeve publike me qytetarë?</p>	<p>1. Numri i kërkesave për qasje në dokumente publike të pranuar dhe procesuara për këtë periudhë është 77.  2. Të gjitha aktet janë të publikuara në të dy gjuhët, shqip dhe serbisht;  3. Gjatë periudhës raportuese janë mbajtur 3 konsultime publike;  4. Kryetari ka takime me qytetarë dy herë në javë: të martën dhe të enjten;</p>	

<p>1.4.Të vazhdohet procesi i decentralizimit për komunat: <b>Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok, Zvecan, Leposaviq</b></p>	<p><b>Drejtoria e Administratës</b></p>	<p>1. A janë themeluar Qendrat për shërbim të qytetarëve? 2.A ka filluar procesi i funksionalizimit të Administratës komunale?</p>	<p>1. Qendrat për shërbim me qytetarë janë të themeluara dhe janë funksionale.</p>	
<p>1.5.Të zbatohet në mënyrë sistematike rekrutimi i stafit civil i cili është bazuar me ligj</p>	<p><b>Drejtoria e Administratës/Zyra e personelit</b></p>	<p>1. Çfarë përpjekje dhe veprime ka ndërmarrë Komuna që Komunitetet jo-shumicë të përfaqësohen në mënyrë adekuate në institucionet publike në komunën tuaj?  2. Sa është numri i të punësuarave të komuniteteve jo shumicë në institucionet publike?</p>	<p>1. Ne Institucionet Publike të Komunës procesi i rekrutimit në punë bëhet konform rregullave të përcaktuara me Ligj.  2. Numri i të punësuarve të komunitetit joshumicë në Administratën e Komunës është 9. Ndërsa ne Institucionet tjera si Zjarrfikes janë 22 nënpunes të komunitetit pakicë të angazhuar;</p>	
<p><b>2. Avokati i Popullit</b></p>				

<p>2.1. Të përmirësohen kushtet për funksionimin e Institucionit të Avokatit të Popullit</p>	<p><b>Drejtoria e Administratës</b></p>	<p>1. A janë të qasshme për personat me aftësi të veçanta, hapësirat e punës së institucionit të Avokatit të Popullit në institucionet lokale?</p>	<p>1. Institucioni i Avokatit të Popullit në Prishtinë i ka hapësirat e qasshme për të gjitha kategoritë;</p>	
<p>2.2. Të zbatohen rekomandimet e Institucionit të Avokatit të Popullit</p>	<p><b>Njësia për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete</b></p>	<p>1. Sa është numri i kërkesave/rekomandimeve të cilat Komuna i ka pranuar nga Institucioni i Avokatit të Popullit?</p> <p>2. Sa përgjigje pozitive i ka kthyer Komuna Institucionit të Avokatit të Popullit?</p> <p>3. Sa përgjigje negative i ka kthyer Komuna Institucionit të Avokatit të Popullit?</p> <p>4. Sa kërkesa/rekomandime janë në proces të shqyrtimit?</p>		

<b>3. Shoqëria civile</b>				
3.1. Të rritet bashkëpunimi në mes të organizatave të shoqërisë civile dhe institucioneve të Qeverisë së Kosovës, si dhe të sigurohet financim publik për shoqërinë civile	<b>Drejtoria për Financa dhe Buxhet</b>	<p>1. Cili është numri i OSHC-ve të përkrahura financiarisht nga komuna?</p> <p>2. Sa është numri i projekteve që ka financuar komuna?</p> <p>3. Sa është shuma e përgjithshme e ndarë për përkrahjen e aktiviteteve të OSHC-ve?</p>	Shuma e përgjithshme e realizuar deri më <b>20.06.2017</b> për përkrahjen e OSHC në formë të subvencioneve është <b>315.393.66</b> euro;	
<b>4. Lufta kundër korrupsionit</b>				
4.1. Të përforcohen strukturat e Kosovës në parandalimin dhe eliminimin e akteve terroriste dhe financimit të tyre	<b>Kordinatori i Sekretariatit/Kuvendi i Komunës</b>	1. Cilat janë veprimet/aktivitetet që ka ndërmarrë komuna e juaj për vetëdijësimin e qytetarëve kundër terrorizmit?	1. Sa i përket aktiviteteve kundër terrorizmit Drejtori i Administratës së bashku me shefen e Kabinetit kanë marr pjesë në organizimin e OSBE-se në bashkëpunim me ICITAP- in me tematikën e ekstremizmit fetar; Si dhe të gjitha problemet eventuale ngritën në takimet e KKSb-së ku janë prezent edhe p5rfaqësuesit e bashkësive fetare;	

<p>4.2.Të krijohen mekanizma për raportim obligativ lidhur me konfliktin e interesit si dhe të ashpërsohen sanksionet lidhur me mos deklarimin e pasurisë dhe konfliktin e interesit</p>	<p><b>Kordinatori i Sekretariatit/Kuvendi i Komunës</b></p>	<p>1.Sa është numri i personave zyrtar që deklarojnë pasurinë tek AKK?</p> <p>2. Sa është numri i personave zyrtar që nuk e deklarojnë pasurinë tek AKK?</p> <p>3.Sa është numri i deklarimeve të konflikteve të interesit nga zyrtarët komunal dhe anëtarët e kuvendit të komunës me rastin e marrjes së vendimeve?</p>	<p>1. Janë 76 persona zyrtar të cilët e kanë deklaruar pasurinë në AAK. Të gjithë këta zyrtarë politikë e kanë deklaruar pasurinë në afatin e paraparë ligjor.</p> <p>2. Gjatë periudhës raportuese nuk ka pasur raste të deklarimit të konfliktit të interesit.</p>	
<p>4.3.Monitorimi i zbatimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit Kundër Korrupsion;</p>	<p><b>Kordinatori i Sekretariatit/Kuvendi i Komunës</b></p>	<p>1. A ka hartuar komuna juaj Planin Lokal për Integritet?</p> <p>2.A ka komuna juaj zyrtar që raporton për Planin Lokal për Integritet ?</p> <p>3.Sa është numri i raporteve të publikuara mbi monitorimin e zbatimit e Planin Lokal për Integritet?</p>	<p>1. Plani Lokal i Integritet i cili në vete përmban edhe komponentën e anti-korrupsionit në Komunën tonë është hartuar në vitin 2014, momentalisht është duke punuar grupi për hartimin e Planit të ri të integritetit 2017 – 2020 (Plani për Integritet – Komuna e Prishtinës 2014 – 2016 ekzistuesi);</p> <p>2. Komuna ka të emëruar për raportim të këtij Plani;</p>	

<p><b>5.Punët e brendshme dhe lufta kundër krimit të organizuar</b></p>				
<p>5.1.Ri-pranimi/ri-integrimi</p>	<p><b>Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim</b></p>	<p>1. A është funksionale Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim, sa zyrtarë janë dhe cili është roli i tyre?</p>	<p>Po, Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim ( ZKKK) është funksionale.</p> <p>Janë 5 zyrtarë dhe roli i tyre është në përputhje me Rregulloren 02/2010 për Zyrat për Komunitete dhe Kthim.</p>	<p>.</p>
<p><b>6.Të drejtat e njeriut dhe mbrojtja e minoriteteve</b></p>				
<p>6.1.Zbatimi i pakove ligjore për të drejtat e njeriut</p>	<p><b>Njësia për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete</b></p>	<p>1.Numri dhe lloji i aktiviteteve të komunës për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut në lidhje me zbatimin e legjislacionit për të drejtat e njeriut?</p> <p>2. A është miratuar rregullorja komunale për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve?</p> <p>3.Sa është numri i trajnimeve për zyrtarët komunal për pakon ligjore për të drejtat e njeriut? (<i>Ligji nr. 05/L -019 për Avokatin e Popullit (LAP), Ligji nr. 05/L -020 për barazi gjinore (LBGJ) dhe Ligji nr. 05/L -021 për mbrojtjen nga diskriminimi</i>)</p>	<p>1. Janë mbajtur këto aktivitete</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Kundër trafikimit –ku janë përfshi të gjitha shkollat e Komunës së Prishtinës me klasat e 9, aktiviteti është realizuar në bashkëpunim me Policinë e Kosovës.</li> <li>- Asambleja e fëmijëve kemi mbajtur aktivitet të rregullta si dhe me 1 qershor mbledhjen solmne .</li> <li>- 7 marsi dita e mësueses</li> <li>- 12 maj “Dhuro gjak , shpëto jetë”</li> </ul> <p>2. Rregullorja Komunale për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve nuk është hartuar ende, por është formuar grupi punues për hartimin e saj;</p> <p>3. Trajnime janë mbajtur gjatë vitit të kaluar, këtë vite nuk ka pasur;</p>	

6.2.Të drejtat e grave dhe barazia gjinore	<b>Zyra për Barazi Gjinore</b>	1. Sa raste të dhunës mbi baza gjinore ka trajtuar komuna juaj?	1. Janë 30 raste të dhunës në familje		
6.3.Të drejtat e fëmijëve	<b>Njësia për të Drejtat e Njeriut</b>	1.Cilat janë veprimet që ka ndërmarrë komuna, duke përfshirë edhe planifikimin buxhetor, për të ngritur kapacitetin e koordinatorit apo zyrtarit komunal për të drejtat e njeriut/fëmijëve?  2. Cilat janë vështirësitë e komunës tuaj për zbatimin e kornizës ligjore për të drejtat e fëmijëve?	1. Nuk ka buxhet  2. Mungesa e buxhetit dhe caktimi i një personi që do mirret vetëm me të drejtat e fëmijëve.		



<p>6.4.Të fuqizohet roli dhe pozita e femrës në shoqëri</p>	<p><b>Zyra për Barazi Gjinore</b></p>	<p>1. Sa është numri i femrave në pozita menaxheriale në të gjitha institucionet e komunës (p.sh. administratë, shkolla, QMF etj)?</p> <p>2.Sa është numri total i përfaqësimit të femrave në administratën publike lokale duke përfshirë Kuvendin e Komunës?</p>	<p>1. Numri i përfaqësimit të grave në pozita menaxheriale në të gjitha institucionet e komunës është <b>6</b> femra në administratë, Shkolla të mesme të ulta <b>12</b> drejtore , shkolla të mesme të larta <b>2</b> drejtore dhe çerdhe <b>8</b> drejtore, QMF- <b>1</b> Drejtore(F) <b>13</b> Femra shefe, (sqarim: Qendra kryesore e MF ka Drejtor dhe zv. drejtor, ndërsa qendrat tjera kanë vetëm Shef/e)</p> <p>2. Numri i përfaqësimit të femrave në administratën publike janë <b>239</b> ndersa mashkuj – <b>316</b> në Administratë , ndërsa në Kuvendin e Komunës janë <b>19</b> femra;</p>	
<p>6.5.Zbatimi i të drejtave pronësore</p>	<p><b>Njësia për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete/Zyra për Barazi Gjinore</b></p>	<p>1. Sa është numri i veprimeve që ka ndërmarrë komuna e juaj me qëllim të rritjes së ndërgjegjësimit dhe përmirësimit për të drejtat pronësore të grave, dhe cila është natyra e tyre?</p>	<p>1. Me hyrjen ne fuqi të <b>UA Nr. 03/2016</b> si dhe me vazhdimin e afatit edhe për një vit është duke u zbatuar dhe i njoftojmë palët lidhje me këtë të drejtë;</p>	
<p>6.6.Lufta kundër trafikimit me qenie njerëzore</p>	<p><b>Njësia për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete /Drejtoria për Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale</b></p>	<p>1. Sa raste të strehimit dhe të kompensimit të viktimave të trafikimit janë evidentuar në komunën tuaj?</p> <p>2. A ka siguruar Komuna ndihmë për viktimat e komuniteteve pakicë kundër</p>	<p>1. Nuk ka asnje rast qe ju ka siguri strehimi;</p> <p>2. Komuna nuk ka siguruar ndonjë ndihmë të veçantë për viktimat e komuniteteve pakicë kundër trafikimit dhe kundër dhunës në familje, mirëpo, në rast se paraqitet ndonjë rast trajtimi i tyre do të bëhet përmes Qendres për Punë Sociale në pajtim</p>	

			trafikimit dhe kundër dhunës në familje?	me legjislacionin në fuqi si për çdo qytetarë tjerë të komunës sonë pa ndonjë diskriminim. Nuk kemi diç të siguar ndonjë ndihmë të veçantë për komunitetet pakicë.	
6.7.Buxheti dhe sfidat në nivel qendror dhe lokal		<b>Drejtoria për Financa dhe Buxhet</b>	1. A ka ndarë komuna juaj buxhet për mbrojtjen e komuniteteve pakicë? Nëse po, sa është buxheti?	-1. Po, buxheti i ndarë investime kapitale është 90.000.00 Euro për komunitetet joshumicë. - Projekte subvencionuese për komunitetet joshumicë RAE, si vijon: - shpërndarja e pakove ushqimore dhe higjienike për nxënësit e komuniteteve RAE; - shënimi i festave zyrtare të komuniteteve joshumicë; - dhurata për fundvit për fëmijët e komuniteteve RAE prej 1-12 vjeç; - projekt subvencionues për rastet që kanë pasur djegie shtëpie nga komunitetet joshumicë; Dhe projekte tjera subvencionuese. Si rezultat i një bashkëpunimi ne mes të përfaqësuesve nga Komiteti per Komunitete dhe drejtorisë së Administrates janë përkrahur 19 familje të komuniteteve pakicë me nga 150 euro;	

6.8.Të përmirësohet implementimi i Ligjit për përdorimin e gjuhëve

**Zyra ligjore/Zyra informimit**

1. A ka komuna juaj rregullore për përdorimin e gjuhëve zyrtare?

2.A është rekrutuar stafi i nevojshëm dhe profesional për përkthim?

3. Çfarë veprime ka ndërmarrë Komuna për të krijuar qasje për shërbime në gjuhët zyrtare në nivel komunal, duke përfshirë gjuhët që përdoren nga komunitetet pakicë në komunën tuaj?

1. Po, komuna e ka Rregullorën për përdorimin e gjuhëve zyrtare;

2. Janë të angazhuar 2 përkthyes shqip – serbisht, përkthyes i gjuhës angleze nuk ka të angazhuar për momentin;

3. Komuna e ka përkthyesin, ka rregulloren për përdorimin e gjuhëve zyrtare dhe në ueb-faqen e komunës publikohen dokumente në gjuhët zyrtare që përdoren në Komunë;

<p><b>7.Mbrojtja dhe promovimi trashëgimisë kulturore</b></p>				
<p>7.1.Avancimi i mbrojtjes së trashëgimisë kulturore</p>	<p><b>Drejtoria e Kulturës/ Drejtoria përgjegjëse për mbrojtjen e trashëgimisë (Urbanizmi)</b></p>	<p>1.Cilat janë veprimet/aktivitetet që komuna juaj ka ndërmarrë lidhur me definimin dhe trajtimin e perimetrave, zonave të mbrojtura, sipërfaqeve të mbrojtura dhe shenjzimin e aseteve të Trashëgimisë Kulturore?</p> <p>2. A është bërë studimi i fizibilitetit dhe projektit ideor në komunën tuaj për sa i përket themelimit të Muzeut të Natyrës?</p> <p>3.A është themeluar Muzeu i Natyrës në Komunën tuaj?</p>	<p>1. Zonat e Mbrojtura janë të përcaktuara dhe definuara me Ligj; 2. Projekti Muzeu i Natyrës nuk është projekt i Komunës së Prishtinës por MKRS-së. 3. Lokacioni për ndërtimin e objektit është caktuar në fshatin Sllatinë, Komuna e Fushë Kosovës, jo në Komunën e Prishtinës.</p>	
<p>7.2.Të implementohet legjislacioni që ka të bëjë me mbrojtjen e trashëgimisë kulturore</p>	<p><b>Drejtoria e Kulturës/ Drejtoria përgjegjëse për mbrojtjen e trashëgimisë (Urbanizmi)</b></p>	<p>1. A ka komuna juaj Plan për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore?</p> <p>2. Sa është numri i shkeljeve dhe ndërtimeve ilegale në zonat e mbrojtura?</p> <p>3. Çfarë masa janë ndërmarrë ndaj shkeljeve të evidentuara të ndërtimeve pa leje në zonat</p>	<p>1. Jo Komuna nuk e ka Planin e Trashëgimisë Kulturore; 2. 3. 4. 5. Komuna e Prishtinës nuk ka nënshkruar Memorandum sa i përket mirëmbajtjes së Kishës Ortodokse;</p>	

			<p>e mbrojtura?</p> <p>4.A janë siguruar pajisjet për monitorimin e sigurisë/instalimi i kamerave të tërësive të trashëgimisë kulturore të Kishës Ortodokse?</p> <p>5. A janë nënshkruar Memorandume të bashkëpunimit për detyrat dhe përgjegjësitë në relacion me mirëmbajtjen e Kishës Ortodokse?</p>		
	<p>7.3.Ndërmarrja e aktiviteteve për të përmirësuar koordinimin mes ministrive (MMPH, MKRS dhe MAPL) dhe për të rritur koordinimin në mes të këtyre ministrive dhe administratave komunale. Planet konkrete për aktivitete të ardhshme.</p>	<p><b>Zyra e Kryetarit/Zyra komunale për Integritet Evropiane</b></p>	<p>1.Çfarë aktivitete ka ndërmarrë komuna për të përmirësuar dhe rritur koordinimin me ministrinë MMPH, MKRS DHE MAPL (specifikoni llojin e aktiviteteve gjatë periudhës raportuese)?</p>	<p>1. Gjatë periudhës raportuese nuk ka pasur ndonjë takim me Ministrinë konkrete sa i përket çështjes së trashëgimisë kulturore;</p>	
	<p>7.4. Raportoni lidhur me organizimin e fushatave të ndërgjegjësimit dhe promovimin e përkushtimit më të fuqishëm për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore</p>	<p><b>Drejtoria e Kulturës</b></p>	<p>1.Cilat janë aktivitetet që komunat kanë ndërmarrë për ndërgjegjësimin dhe promovimin për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore? 2. Cilat janë format e bashkëpunimit me Qendrën</p>	<p>1. Drejtoria e Kulturës gjatë një viti kalendarik shpallë thirrje të ndryshme për aplikim për subvencionim të projekt - propozimeve. Projektet konkurruese mund të kenë elemente të ndryshme për ndërgjegjësimin dhe promovimin e</p>	

			Rajonale për Trashëgimi Kulturore?	mbrojtjes së trashëgimisë kulturore.  2. Komuna e Prishtinës është në komunikim të vazhdueshëm me QRKT-në rreth projekteve për ndrëhyrje emergjente në objekte nën mbrojtje të ligjit për trashëgimi kulturore.	
--	--	--	------------------------------------	---	--

## 2. BLOKU II: KRITERET EKONOMIIKE

	<b>1. Ekzistenca e ekonomisë funksionale të tregut</b>				
	1.1. Përmirësimi i mëtejshëm i ambientit në të bërit biznes	<b>Drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe Turizem</b>	<p>1.Çfarë ka bërë komuna juaj në zvogëlimin e mëtejshëm të barrierave në të bërit biznes?</p> <p>2.Sa është numri i bizneseve të regjistruara?</p> <p>3.Sa është numri i bizneseve të mbyllura?</p> <p>4.Sa ka ndarë buxhet komuna për subvencionimin e bizneseve?</p> <p>5.A janë funksionale Qendrat për promovimin e bizneseve?</p>		

1.2. Modernizimi i mbledhjes së të hyrave, për të reduktuar varësinë nga faturat doganore duke përmirësuar mbledhjen e tatimit në pronë dhe forcimin e kornizës ligjore për mbledhjen e tatimit dhe borxheve nga taksat komunale

**Drejtoria për financa  
Sektori i Buxhetit**

1. A është bërë modernizimi i mbledhjes së të hyrave duke përmirësuar mbledhjen e tatimit në pronë?

2. Sa është përqindja e të hyrave të tatimit në pronë në të hyrat e përgjithshme të komunës?

1. Kemi ndërmarrë disa masa për përmirësimin e mbledhjes së të hyrave nga tatimi në pronë, duke i grupuar në pesë fusha kryesore e që janë:

1. Baza e të dhënave e tatimit në pronë,
2. Vjelja dhe vjelja e detyruar,
3. Sigurimi i burimeve për njësinë e tatimit në pronë,
4. Përmirësimi i përcaktimit të vlerës së pronave, si dhe
5. Transparenca dhe marrëdhëniet me publikun

Puna në **Bazën e të dhënave të tatimit në pronë**, është përqendruar në regjistrimin e rregullt të pronave të reja, verifikimin dhe përditësimin e pronave ekzistuese si dhe komunikim i shtuar ndërmjet Zyrës së tatimit në pronë dhe Zyrës së kadastrës.

Puna në **Vjelje dhe vjeljen e detyruar** është përfshirë aktivitete në përmirësimin e performancës së vjeljes, masat bindëse, vjeljen e detyruar, kushtëzimet e shërbimeve. Kemi vepruar duke kontaktuar me borxhlinjtë e mëdhenj -“Këqij” duke filluar me pronat komerciale dhe industriale, e pastaj kemi vazhduar me borxhlinjtë e me prona të mëdha rezidenciale.

Puna në **Sigurimin e burimeve për Njësinë e tatimit në pronë**, kemi rritur resurset njerëzore, kemi siguruar pajisje të mjaftueshme siç janë GPS për regjistrimin e pronave, mjetet e transportit si dhe pajisje telefonike. Kemi përgatitur stafin e TP duke ofruar trajnime substanciale nga Departamenti i tatimit në pronë në Ministrinë e financave.

Kemi modifikuar dhe kemi bërë **Vlerësimin e patundshmërisë**, duke përdorur më së shumti metodën e shitjes, metodën e të ardhurave, anketim në teren etj., e cila është propozuar me pastaj për ndryshimin e Rregullores së tatimit në pronën e paluajtshme, duke ndryshuar vlerësimin e pronave të paluajtshëm në territorin e Prishtinës, gjithnjë me qëllim që të bëhet vlerësimi më i saktë i vlerës së pronave që do t'atohen.

Puna në **Transparencën dhe marrëdhëniet me publikun**, kemi rritur transparencën si dhe Komunikimin e stafit të ZTP me qytetarët, gjegjësisht tatimpaguesit. Kemi realizuar edhe kampanjën e tatimit në pronë, e cila ka të bëjë me ngritjen e vetëdijes së qytetareve lidhur me rendësin e tatimit në pronë dhe përfitimet që do t'ju sjellin qytetarëve me pagesën e tatimit në



				<p>pronë. Vlen të theksohet se kjo kampanjë ka pasur mjaftë sukses për vetëdijesim të qytetarëve.</p> <p>2. Nga Janari deri më <b>20.06.2017</b> nga të hyrat e planifikuara prej <b>5.287.375.00</b> janë realizuar <b>2.854.446.84</b>, që në përqindje i bie <b>53.99%</b></p>	
	<p>1.3.Procedurat e planifikimit të buxhetit nuk kanë qenë transparente dhe të koordinuar deri më tani. Programet e shpenzimeve të buxhetit nuk janë përputhur me prioritetet afat gjata të qeverisë.</p>	<p><b>Drejtoria për Financa dhe Buxhet</b></p>	<p>1.Sa dëgjime publike janë mbajtur për planifikimin e buxhetit? (të raportohet në K4)</p> <p>2. Cilat janë format e përfshirjes së qytetarëve, shoqërisë civile dhe grupeve tjera të interesit në planifikimin e buxhetit?</p>	<p>1. Raportohet në pjesën e dytë të vitit, përshkak se dëgjimet publike për planifikimin e buxhetit mbahen në muajin Gusht. Gjatë viti 2016, i kemi mbajtur 8 dëgjime buxhetor.</p> <p>2. Komuna e Prishtinës gjatë gjithë kohës i përfshin qytetarët, shoqërinë civile dhe grupet e tjera të interesit në planifikimin e buxhetit në forma të ndryshme, duke filluar nga kërkesat të cilat i bëjnë qytetarët në Qendrën për shërbim me qytetarë për çështje të caktuara. Poashtu, Komuna e Prishtinës e ka Platformën Digjitale për participim publik, ku është një ueb adresë në internet që shërben për komunikim në mënyrë interaktive dhe transparente në mes</p>	

				banorëve të komunës dhe zyrtarëve komunal, përmes së cilës çdo qytetar ka mundësi të bëjë propozime, duke regjistruar ide apo rekomandime për lagjen ku jeton. Deri më tani në këtë platformë kemi pranuar 142 kërkesa, 5 prej tyre janë realizu, kurse të tjerat do të merren parasysh gjatë hartimit të buxhetit për vitin 2018;	
	<b>2. Kapitulli 16 i acquis-së: Tatimet</b>				
	2.1.Zvogëlimi i nivelit të ekonomisë joformale dhe evazionit fiskal;	<b>Drejtoria e Inspektoriatit</b>	<p>1. Sa është numri i inspektimeve me qëllim të parandalimit të ekonomisë joformale dhe evazionit fiskal?</p> <p>2. Cilat janë masat që ka ndërmarrë komuna juaj ndaj subjekteve ekonomike me qëllim të parandalimit të ekonomisë joformale?</p>	<p>1. Per evazion fiskal përgjegjës është Administata Tatimore e Kosoves - ATK.</p> <p>2. Ne si drejtori e Inspektionit- Sektori i Rendit Komunal ne rastet kur operatorët apo subjektet afariste i hasim duke operu ilegalisht i Obligojme te paisen me dokumentet përkatëse per ushtrim te kësaj veprimtarie.</p>	
<b>3. BLOKU III: STANDARDET EVROPIANE</b>					

<p><b>1. Kapitulli 6 i acquis-së: E drejta e kompanive</b></p>				
<p>1.1. Lehtësimi i procedurave të bërjes biznes në komuna</p>	<p><b>Drejtoria e Administratës</b></p>	<p>1.A është themeluar Qendra për regjistrimin e bizneseve (one-stop shopet) në komunën tuaj ?</p> <p>2. Sa është numri i trajnimeve të organizuara për stafin e Qendrave për regjistrimin e bizneseve (one-stop shopet) në komunën tuaj?</p> <p>3. Sa është numri i stafit të trajnuar në këtë fushë?</p>	<p>1. Jo ende nuk është themeluar qendra për regjistrimin e bizneseve;</p>	
<p><b>2.Kapitulli 11 i acquis-së: Bujqësia dhe zhvillimi rural</b></p>				
<p>2.1.Zhvillimi i mëtejshëm i politikave në fushën e bujqësisë, me qëllim të zbatimit të dispozitave të MSA-së dhe acquis-së së transpozuar</p>	<p><b>Drejtoria për Bujqësi</b></p>	<p>1. A ka hartuar dhe aprovuar komuna juaj Plan Program për Bujqësi dhe Zhvillim Rural?</p>	<p>1. Zyra për Shërbime Këshillimore e posedon Planin e Veprimit të këshillimeve – konsultave dhe informimit zyrë – terren dhe anasjelltas, plan ky i hartuar nga MBPZHR, që përfshin numrin e fermerëve, metodat e këshillimit, temat për të cilat ata kanë nevojë;</p>	

<p>2.2.Rregullimi i mëtejshëm i tokës bujqësore dhe mbrojtjes nga ndërrimi i destinimit të tokës bujqësore</p>	<p><b>Drejtoria për Bujqësi</b></p>	<p>1.Sa është numri i kërkesave të parashtruara, pëlqimeve dhe vendimeve të lëshuara për ndërrimin e destinimit të tokës?</p> <p>2.Plani Zhvillimor Komunal, a përfshinë Zonat Urbane dhe Rurale, në komunën tuaj?</p> <p>3. A ka përgatitur komuna juaj Master planin për rregullimin e Tokës Bujqësore?</p>	<p>1. Gjatë periudhës raportuese Janar – Qershor në Drejtorinë e Urbanizmit janë pranuar 13 kërkesa për ndërrimin e destinacionit të tokës bujqësore, kerksat janë përcjellur në MBPZHR për procedim të mëtutjeshëm;</p>	
<p>2.3.Konsolidimi i mëtejshëm i qendrave informative këshilluese komunale për bujqësi dhe zhvillim rural</p>	<p><b>Drejtoria për Bujqësi</b></p>	<p>1.A janë funksionalizuar qendrat informative për trajnimin e fermerëve në komunën tuaj?</p>	<p>1. Me datë <b>21.04.2017</b> është zyrtarizuar zyra – <b>Qendra për Shërbime Këshillimore Bujqësore, Rurale të Kosovës.</b></p>	
<p><b>3.Kapitulli 12 i acquis-së: Politikat e sigurisë së ushqimit, fitosanitare dhe ato të veterinarisë</b></p>				
<p>3.1.Përmirësimi i mbrojtjes së shëndetit publik dhe shëndetit të kafshëve</p>	<p><b>Drejtoria për Bujqësi</b></p>	<p>1.Sa është numri i fermerëve të trajnuar për mirëqenien e kafshëve?</p>	<p>1. Zyra Këshillimore gjatë periudhës raportuese Janar – Qershor nuk ka pasur trajnime për mirëqenien e kafshëve, por janë mbajtur trajnime për pemëtari, ruajtje dhe konzervim. Në prag të këshillimit është drejtimi i blegtorisë ku do të përfshihen higjiena e stallës, pastërtia e</p>	

				qumështit dhe përpunimi i qumështit; këshilla për mbrojtjen nga sëmundje të mundshme si ajo gungore e vitit të kaluar apo sëmundje tjera që mund të paraqiten, gjithnji në bashkëpunim me Stacionin e Veterinës (Veterinari përkatës);	
	<b>4. Kapitulli 15 i Acquis-së: Energjia</b>				
4.1. Reformimi i strukturave institucionale në fushën e energjisë dhe sigurisë bërthamore dhe ngritja e kapaciteteve të tyre, me qëllim të zbatimit të dispozitave të MSA-së dhe acquis-së së transpozuar	<b>Drejtoria Shërbimeve Publike</b>	e	1. A ka miratuar komuna juaj Planin për Efiqencë të Energjisë?  2. Sa është numri i trajnimeve të mbajtura për zyrtarët komunal për zbatimin e masave të dala nga Planet Komunale për Efiqencë të Energjisë?	1. Komuna e Prishtines ka planin per efiqence si dhe Planin e veprimit per efiqence. 2. Gjate viti 2017 jane bere dy trajnime per efiqence te energjise.	
4.2. Ka pasur përparim në planifikimin e efiqencës së energjisë në komuna, por nevojat e kapaciteteve lokale duhet forcuar	<b>Drejtoria Shërbimeve Publike</b>	e	1. Cilat janë aktivitetet konkrete për zbatimin e planit për efiqencë të energjisë?	1. Si aktivitet për zbatimin e Planit për efiqencë të energjisë janë marr masa ne objekte komunale dhe ne ndriqim publike;	

<p>4.3.Zbatimi i masave për efikasitet të energjisë dhe ngritja e efikasitetit të energjisë në objektet publike</p>	<p><b>Drejtoria Shërbimeve Publike</b></p>	<p>1.Çfarë masa ka ndërmarr komuna juaj për zbatimin e planit për EE në objektet publike?</p>	<p>1. Ndërrimi i kalldajave me djegie nafte dhe thengjill në ato me biomase në institucione shkollore;</p> <p>Projekt i veçantë për qytetin e Prishtinës është kyqja në sistemin e koogjenerimit për ngrohje, ku është përjashtuar 100% ngrohja me mazut në Termokos;</p>	
<p><b>5. Kapitulli 23 i acquis-së: Gjyqësori dhe të drejtat themelore</b></p>				
<p>5.1.Promovimi i mundësive të barabarta dhe lufta kundër diskriminimit</p>	<p><b>Njësia për të Drejtat e Njeriut</b></p>	<p>1. A zbatohet Ligji për mbrojtje nga Diskriminimi në respektimin e të drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuar?</p> <p>2.Cilat janë veprimet që ka ndërmarr komuna juaj, për zbatimin e Ligjit për mbrojtje nga Diskriminimi?</p>	<p>1. Ligji për mbrojtje nga diskriminimi në respektimin e personave me aftësi të kufizuara respektohet sipas mundësive, mbetet ende punë për tu bërë.</p>	
<p>5.2.Ofrimi i ndihmës juridike falas për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, pa dallim etnie</p>	<p><b>Drejtoria Administratës</b></p>	<p>1. A është funksionalizuar Zyra për ndihmë juridike falas?</p> <p>2. A është bërë rekrutimi i zyrtarëve për ndihmë juridike falas në komunën tuaj ?</p>	<p>1. Në komunën e Prishtinës nuk është funksionalizuar zyra për ndihmë juridike falas, por zakonisht ekziston një praktikë ku qytetarët marrin këshilla nga zyra ligjore, ku janë të angazhuar 5 zyrtarët si dhe shefi i zyrës;</p>	

5.3. Ngritja e kapaciteteve institucionale në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale	<b>Drejtoria e Administratës</b>	<p>1. A është trajnuar zyrtari për mbrojtjen e të dhënave personale në komunën tuaj?</p> <p>2. A është funksionalizuar baza e të dhënave personale për zyrtarët komunal?</p>	<p>1. Po vitin e kaluar ka pasur trajnime;</p> <p>2. Te gjitha te dhënat e personelit janë futur ne sistemin informativ dhe menaxhues te burimeve njerëzore;</p>	
5.4. Duhet siguruar që Zyrat Komunale të Gjendjes Civile (ZKGJC) dhe zyrat e vendit të plotësojnë kriteret e sigurisë për regjistrimin civil, por edhe kriteret e ruajtjes dhe mbajtjes së dokumenteve personale	<b>Drejtoria e Administratës</b>	<p>1.A është ngritur siguria fizike e dokumentacionit (roja fizike, vendosja e kamerave, grilat, kasafortat,etj.)?</p> <p>2. A mbahen librat fizik në komunën tuaj? Nëse jo, kur do fillohet të bëhet kjo?</p>	<p>1. Po siguria fizike e dokumentacionit është sipas rregullave dhe konsultave me ARC-në;</p> <p>2. Po librat fizik janë në komunë;</p>	
5.5. Verifikimi i kërkesave të personave të riatdhesuar, respektivisht tek gjendja civile në komuna, si dhe përmes Zyrës për Komunitete dhe Kthim (ZKK) dhe Komisionit Komunal për Ri-integrim	<b>Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim</b>	1. Në komunën tuaj, a bëhet verifikimi i kërkesave të personave të riatdhesuar përmes Zyrës Komunale të Gjendjes Civile, Zyrës për Komunitete dhe Kthim, si dhe Komisionit Komunal për Ri-integrim?	1. Kërkesat e personave të riatdhesuar shqyrtohen, ashtu siç parashihet në Rregulloren nr. <b>02/2016</b> për riintegrimin e personave të riatdhesuar dhe menaxhimin e programit të riintegrimit. Pra, kërkesat e personave të riatdhesuar procedohen në KKR dhe mekanizmat tjerë komunalë, në rast se kanë të bëjnë me arsimin, regjistrin civil, etj.	

5.6. Ofrimi i mundësive për kthim për personat e zhvendosur

**Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim/ Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenës Sociale**

1. Sa është numri i personave të zhvendosur të rikthyer, të cilët janë regjistruar në komunën tuaj?

2. Sa është numri i shtëpive të rindërtuara për të rikthyerit?

3. Sa është numri i aplikimeve për asistencë nga fondi për ri-integrim?

4. Sa është numri i aplikimeve për zhvillimin e bizneseve nga personat e riatdhesuar?

5. Sa është numri i personave të riatdhesuar të cilët janë pajisur me dokumente personale?

1. Nuk ka pasur persona të zhvendosur që janë kthyer gjatë kësaj periudhe raportuese.

2. Janë në proces 4 raste për ndërtim shtëpie, që presin kontraktimet tenderuese dhe implementuese për rindërtim të shtëpive në Ministrinë për Komunitete dhe Kthim.

3. Kanë aplikuar 13 raste.

4. Kanë aplikuar 45 raste, që janë në pritje të verifikimit të raportit në terren.  
Janë miratuar 11 planbiznese.

5. Me dokumente personale janë pajisur 5 të riatdhesar.

**Përgjigja nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale:** - Komuna e Prishtinës ka vullnet politik për ofrimin e mjedisit të sigurt dhe mundësinë e kthimit të të gjithë qytetarëve të vet, të cilët janë zhvendosur brenda dhe jashtë Kosovës, pa dallim etnie, feje dhe përkatësie politike. Në këtë drejtim



				ju informojmë se komuna ka hartuar “Planin Komunal të Veprimit për të Zhvendosurit dhe Zgjidhje të Qëndrueshme” i cili duhet të miratohet në Kuvendin e Komunës;	
5.7. Zbatimi i Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Komunitetet RAE dhe përmirësimi i shkallës së regjistrimit civil për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptas	<b>Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim</b>	1. Sa është numri i personave të regjistruar nga komunitet Rom, Ashkali dhe Egjiptian? 2. Sa është numri i fushatave të realizuara të regjistrimit falas? 3. A është miratuar Plani Lokal i Veprimit për Integrimin e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në komunën tuaj?	1. Fushata për regjistrimin falas në Komunën e Prishtinës për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian është nga 15 Qershori deri më 31 Korrik 2017. 2. Gjate periudhës raportuese nuk janë realizuar fushata vetëdijesuese. 3. Po, është miratuar.		

**6. Kapitulli 24 i acquis-së: Drejtësia, liria dhe siguria**

6.1. Përmirësimi i mëtejshëm i kornizës së politikave në fushën e migracionit, me qëllim të zbatimit të dispozitave të MSA-së dhe të legjislacionit të përafuar

**Zyra Komunal për Kthim dhe Komunitete**

1. A është miratuar Plani Lokal i Veprimit për Riintegrim në komunën tuaj?

1. Po Plani Lokal për Riintegrim është miratuar.

6.2. Të përmirësohet siguria dokumenteve, duke siguruar zbatimin e dispozitave të MSA-së dhe legjislacionit vendor

**Drejtoria e Administratës**

1. A është përfunduar procesi i digjitalizimit të librave të gjendjes civile të kthyer nga Serbia?

2. Sa zyrtar komunal janë certifikuar (që u janë nënshtruar testit të njohurive ligjore/procedurale dhe të sistemit)?

1. Procesi i digjitalizimit të librave të gjendjes civile nuk i përket nivelit lokal;  
2. Janë 40 zyrtarë të certifikuar që i janë nënshtruar testit;

**7. Menaxhimi i Kufirit dhe Migracionit**

<p>7.1.Puna dhe roli i Këshillat Lokale për Siguri Publike, (KLSP) dhe Ekipet Vepruese për Siguri në Bashkësi, (EVS) të cilat përveç që duhet të jenë funksionale ato duhet të jenë edhe produktive</p>	<p><b>Zyra e Kryetarit</b></p>	<p>1.A janë funksionale Këshilli Lokal për Siguri Publike (KLSP) dhe Ekipet Vepruese për Siguri në komunën tuaj?</p> <p>2. Sa është numri i takimeve të mbajtura nga KLSP dhe EVS?</p> <p>3. Çfarë aktivitete kanë ndërmarrë për periudhën raportuese?</p>	<p>1. M e vendim të kryetarit te Komunes eshte funksionalizuar KLSP – Qendra eshte funksionale (Kryetari, zv Kryetari dhe 17 anetare), po ashtu funksionale janë edhe KLSP Bardhosh si dhe KLSP Drdani.</p> <p>Ekipet vepruese po ashtu janë funksionale.</p> <p>2. Takimet e rregullta, cdo 6 muaj, KLSP – Qendra mban takim me qytetare cdo muaj.</p> <p>3. Me mbështetjen e Ambasades Norvegjeze e implementuar nga OSBE eshte realizuar projekti i pare ne vlere 3000 euro (2015) eshte furnizuar çerdhja IP “Buzeqeshja” me mbulesa. Projekti tjetër qe eshte ne implementim per vendosjen e dy kamera rrotulluese, me vlere 8000 euro, me përkrahje te ambasadës norvegjeze;</p>	
<p>7.2. Të dëshmohen rezultate konkrete në fushën e luftimit të narkotikëve</p>	<p><b>Drejtoria për Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale/Drejtoria e Arsimit/Policia e Kosovës</b></p>	<p>1.Çfarë aktivitete konkrete janë ndërmarrë nga komuna, në luftën kundër drogave dhe parandalimit të trafikimit të narkotikëve?</p>	<p>1. Drejtoria e Shëndetësisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Arsimit kanë organizuar ligjërata me tema të ndryshme në disa shkolla të Komunës së Prishtinës,ku një ndër to ka qenë edhe për luftën kundër drogave dhe parandalimit të trafikimit të narkotikëve. Komuna e Prishtinës në bashkëpunim me OJQ Labyrinth dhe me HOPS nga Shkupi kanë implementuar me sukses projektin: “Parandalimi i transmetimit të HIV dhe drogave në mesin e popullësisë rezidente në zonën ndërkufitare.</p>	

- Komunat targetuese të këtij projekti kanë qenë: Komuna e Prishtinës, Gjilani, Prizreni, Kaçaniku si dhe Komunat e Shkupit: Tetova, Gostivari dhe Kumanova.

**- Objektivat specifike të arritura përmes këtij projekti:**

1. Ngritja e vetëdijes mbi parandalimin e transmetimit të VIV-it;

2. Promovimi i partneritetit mes sektorit publik dhe civil në krijimin e mekanizmave të qëndrueshëm për parandalimin e HIV-it;

3. Dhe promovimi i bashkëpunimit ndërkufitarë në mes të institucioneve dhe organizatave lokale të zonave ndërkufitare si një mjet i vlefshëm i shkëmbimit të praktikave më të mira dhe arritja e rezultateve afatgjate në nivelin rajonal.

\* Komuna e Prishtinës në përputhje me strategjinë kombëtare të Republikës së Kosovës kundër narkotikëve dhe planit të veprimit ka hartuar ***“Strategjinë Lokale Kundër***

***Narkotikëve dhe Planin e Veprimit i Komunës së Prishtinës 2017-2019”, me qëllim që kjo strategji lokale parasheh dhe shtyenë organizatat përkatëse që t’i zbatojnë përgjegjësitë e tyre në planin e veprimit siç parasheh kjo strategji. Janë zhvilluar aktivitete me qëllim të:***

***a. Ngritjes së nivelit të njohurive tek të rinjtë mbi drogat dhe përdorimin e tyre’***

***b. Ngritjes së nivelit të njohurive të profesionistët dhe prindërit për punën me të rinjtë në drejtim të parandalimit nga përdorimi i drogave dhe krijimi i varësisë;***

***c. Fuqizimit të programeve për parandalimin dhe përdorimin e drogave ndërmjet të rinjve nëpërmjet aktiviteteve specifike;***

***d. Përmirësimit të bashkëpunimit dhe koordinimit mes organizatave qeveritare dhe joqeveritare për realizimin e aktiviteteve programore për parandalim.***

1.

**8. Kapitulli 26 i acquis-së: Arsimi dhe kultura**

<p>8.1.Ngritja e kapaciteteve teknike për Arsimin Gjithpërfshirës</p>	<p><b>Drejtoria e Administratës</b></p>	<p>1.A është pajisur me pajisje të teknologjisë informative 1 qendër burimore në Komunën e Prishtinës?</p>	<p>1. Qendra për këshillim në karrierë funksionale dhe e pajisur me teknologji informative;</p>	
<p>8.2. Zbatimi i planit të veprimit nga Strategjia ndërministrrore për shkollat promovuese të shëndetit 2009-2018</p>	<p><b>Drejtoria për Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale/Drejtoria e Arsimit</b></p>	<p>1. A janë ndërmarrë aktivitetet vetëdijësuese në shkolla për shëndet dhe mjedis?</p>	<p>1. Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në bashkëpunim me Drejtorinë e Arsimit – Komuna e Prishtinës, ka bërë implemetimin e projektit për edukimin dhe promovimin shëndetësor, në shkollat e Prishtinës. Ky projekt është i rëndësishëm për edukimin e rinisë, duke marrë parasysh se në të ka tema të ndryshme e mjaft interesante dhe relevante për moshën e nxënësve si:(Higjiena, Stili i jetës së shëndoshë( ushqimi dhe aktiviteti fizik), Delikuenca( duhani, alkooli, droga), Edukimi seksual ( shëndeti riprodhues, sëmundjet seksualisht transmise), Komunikimi ( barazia gjinore, dhuna, ngacmimi, etiketimi), Shëndeti oral, Shëndeti mendor ( depresioni ). Në këtë projekt do të përfshihen të gjitha shkollat, mirëpo fillimisht në këtë projekt janë përfshirë tri SHFMU, “Pjetër Bogdani”, “Xhavit Ahmeti”</p>	

				dhe "Shkëndija".	
8.3. Rritja e nivelit të pjesëmarrjes së fëmijëve në institucionet e edukimit parashkollor dhe fëmijët me nevoja të veçanta	<b>Drejtoria e Arsimit</b>	<p>1. A është zbatuar udhëzuesi për mësimdhënës për vlerësimin e nxënësve me nevoja të veçanta në mësim-nxënie?</p> <p>2. Sa është numri i fëmijëve të cilët janë përfshirë në institucionet e arsimit parashkollor?</p> <p>3.A është hartuar pakoja e materialeve për informimin e prindërve rreth rëndësisë së arsimit të fëmijëve me nevoja të veçanta dhe a është bërë shpjegimi i procedurave të regjistrimit?</p>	<p>1. DKA, komfor Udhëzimeve Administrative, krijon kushtet të barabarta për përfshirjen e të gjithë fëmijëve me aftësi të kufizuara në arsim dhe edukim;</p> <p>2. Gjithsej numri i fëmijëve me nevoja te veçanta ne institucionet parashkollore është 39, ku përfshihen tetë (8) kopshte publike edhe katër (4) kopshte me bazë në komunitet;</p> <p>3. Prindërit janë të informuar për procedurat e regjistrimit dhe rëndësisë së arsimit të tyre. MASHT, konkretisht Divizioni për fëmijë me nevoja të veçanta ka bërë hartimin e udhëzimeve administrative, si dhe broshurave të ndryshme të cilat ne i implementojmë;</p>		
8.4. Raportim me të dhëna mbi numrin e braktisjes së shkollimit nga komuniteti pakicë, në veçanti komuniteti RAE. Veprimet konkrete të ndërmarra nga komuna në parandalimin e mëtejshëm të braktisjes së shkollimit	<b>Drejtoria e Arsimit</b>	<p>1.Sa është numri i braktisjes së shkollimit nga komuniteti pakicë?</p> <p>2.Çfarë ka bërë komuna në parandalimin e braktisjes së shkollimit?</p>	<p>1. Të gjitha shkollat e Komunës së Prishtinës kanë të formuara ekipet për parandalim të braktisjes, ekipe të cilat punojnë brenda secilës shkollë. Ekipet në fjalë janë trajnuar nga MASHT-i lidhur me punën e tyre, për parandalimin e kësaj dukurie.</p> <p>2. Për të gjithë ata që kanë braktisur shkollimin DKA organizon mësim intenziv në SHFMU "Emin Duraku".</p>		

**9. Kapitulli 27 i acquis-  
së: Mjedisi**

9.1. Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të mbeturinave në Kosovë

**Drejtoria Shërbimeve Publike** e

1.A është hartuar plani për menaxhimin e mbeturinave komunale?  
  
2. Cfare aktivite ka ndërmarrë komuna e juaj për zbatimin planit për menaxhimin e mbeturinave komunale?

1. Në Komunën e Prishtinës është hartuar Plani i ri për menaxhimin e mbeturinave si dhe Rregullorja për menaxhimin e mbeturinave;  
2. Në kuadër të zbatimit të Planit për menaxhimin e mbeturinave është bërë zgjerimi i shërbimit për mbeturina ne zonat rurale ku dhe ka bere furnizimin me kontejner **120** dhe **240** litra;  
  
Po ashtu zonën e qytetit e ka furnizuar me kontejner **1.1 m<sup>3</sup>**;  
  
Ka bërë largimin e deponive ilegale me mbetje inerte dhe mbeturina tjera në disa vende pas largimit te mbeturinave është rregulluar hapësira gjelbëruese;

9.2. Ngritja e kapaciteteve administrative në nivelin lokal, për zbatimin e ligjit për mbeturina

**Drejtoria Shërbimeve Publike** e

1. Sa është numri i punëtorive të organizuara në komunën tuaj për hartimin e planeve komunale dhe rregulloreve për mbeturina?

1. Plani është hartuar ne bashkepunim me organizaten Qeveritare Gjermane GIZ dhe zyrtareve të komunës në ekip prej 4 zyrtare nga GIZ dhe 4 zyrtare nga komuna;  
  
2. Per mnaxhimin e mbeturinave janë



			2. Sa është numri i stafit të trajnuar ?	të trajnuar 5 zyrtarë;	
9.3. Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të mbeturinave në Kosovë	<b>Drejtoria Shërbimeve Publike</b>	e	1.Sa është numri i fushatave të ndërmarra për ndërgjegjësimin publik për sistemin e menaxhimit të mbeturinave?	1. Per sistemin emenaxhimit te mbeturinave është duke u zhvilluar një fushatë vetëdijesuese.	
9.4. Përmirësimi i qasjes, cilësisë, qëndrueshmërisë financiare të performancës mjedisore të sektorit të menaxhimit të mbeturinave	<b>Drejtoria Shërbimeve Publike</b>	e	1. A është përgatitur vlerësimi dhe plani reformues i sektorit të menaxhimit të mbeturinave të ngurta?  2. A është përgatitur inventari për mbeturina të rrezikshme dhe vlerësimi i gjendjes?	1. Plani vlerësues dhe plani reformues për menaxhimin e mbeturinave të ngurta është punuar, por sfide mbetet edhe më tej caktimi i lokacionit per deponin e mbetjeve inerte. 2. Menaxhimi mbeturinave të rrezikshme është në kompetence te nivelit qendror.	
9.5.Zbatimin i masave për mbrojtjen e Zonave Ujore Sanitare	<b>Drejtoria Shërbimeve Publike</b>	e	1. A ka përfshirë komua e juaj zonat e mbrojtura ujore sanitare në Planin Rregullues Detajor?	1. Po, ujerat janë përfshirë ne Planin Rregullues detal.	
9.6. Numri i madh i deponive ilegale duhet të adresohet urgjentisht	<b>Drejtoria Shërbimeve Publike</b>	e	1. Sa është numri i deponive ilegale në komunën tuaj dhe çfarë masa ka ndërmarrë komuna për të eliminuar këto deponi?	1. Këtë vit kemi evidentuar rreth <b>120</b> deponi ilegale në sasi nga <b>1 m<sup>3</sup></b> deri në sasi kamioni, por është në krahasim me vitin e kaluar është sasi shumë më e vogël. Në fund të vitit 2016 dhe fillimi i këtij viti kemi larguar mbi <b>170</b> deponi ilegale. Disa lokacione janë kthyer në hapësira gjelbruese.	

9.7. Ngritja e kapaciteteve institucionale për zbatim të legjislacionit në fushën e mjedisit	<b>Drejtoria Shërbimeve Publike/Drejtoria e Urbanizmit</b>	e	1.Sa është numri i punëtorive të mbajtura për zbatim të legjislacionit mjedisor?  2. Sa zyrtarët mjedisor komunal janë trajnuar për legjislacion mjedisor?	1. Në kuadër të Drejtorisë për Shërbime Publike janë mbajtur <b>2</b> trajnime për qeshtje mjedisore; 2. Nga Drejtoria për Shërbime Publike janë trajnuar <b>3</b> zyrtarë për qeshtje mjedisore;	
<b>10. Bujqësia dhe peshkataria</b>					
10.1. Masat e ndërmarra për mbrojtjen e tokës bujqësore	<b>Drejtoria Inspektoratit</b>	e	1. A ka komuna juaj inspektor te bujqesise?  2. Sa është numri i kërkesave të parashtruara?  2. Sa është numri i lejeve të lëshuara?  3. Sa është numri i inspektimeve?	1. Ne kuadër te Drejtoriesë të Inspektionit kemi inspektor të rendit komunal me kompetenca edhe për kete lëmi; Numri i inspektoreve është 27.  2. Gjatë periudhës raportuese janë 133 lëndë – Kërkesa dhe Ankesa të ndryshme nga qytetarët;	

			4. Sa është numri i fletëparaqitjeve parashtruara?	<p>3. Drejtoria e Inspektionit – Sektori i Rendit Komunal lëshojmë vetëm Pelqime Sanitare ndërsa numri i tyre është 86;</p> <p>4. 1531 inspektime te inspektorëve në terren nga Sektori i Rendit Komunal.</p> <p>5. 77 gjoba të ndryshme dhe 408 inicim të lëndëve ne Gjykatë nga Sektori i Rendit Komunal.</p>	
10.2. Planet për menaxhimin e tokave rurale (zonimi)	<b>Drejtoria e Bujqësisë</b>	1.A posedon komuna e juaj Planin për Menaxhimin e tokave rurale?		1. Jo komuna nuk e ka Planin për menaxhimin e tokës rurale;	
<b>11.Zhvillimi Rajonal</b>					
11.1.Pjesëmarrja e komunës në programet e BNK-së (bashkëpunimit ndërkufitar)	<b>Zyra e Kryetarit të komunës</b>	1.Sa është numri i projekteve të BNK-së që komuna është pjesëmarrëse?		1. Gjatë periudhës raportuese komuna e Prishtinës nuk ka pjesëmarrje në programet e bashkëpunimit ndërkufitar.	

11.2.Marrëveshjet e bashkëpunimit ndër-komunal dhe bashkëpunimit komunal ndërkombëtar

Zyra e Kryetarit të komunës

1.Sa është numri i marrëveshjeve të bashkëpunimit ndër-komunal?

2.Sa është numri i marrëveshjeve të bashkëpunimit komunal ndërkombëtar?

2. Komuna e Prishtinës është pjesë e Unionit të Bashkive Shqiptare. Union i cili është krijuar me datë **28 Nëntor 2016**, në mes të Komunës së Prishtinës, Tiranës, Tetovës, Ulqinit dhe Preshevës. (Linku: <http://prishtinaonline.com/kerkimi/1101/memorandum-bashkpunimi-i-unionit-t-bashkive-shqiptare> ). Kanë qenë 5 prezantime të fushave të ndryshme që janë prezantu nga Komuna e Prishtinës (Linku: <http://prishtinaonline.com/kerkimi/1097/drejtori-i-administrates-muhedin-nushi-ne-konferencen-e-unionit-te-bashkive-shqiptare-foli-per-inovacionet-dhe-digjitalizimin-ge-eshte-ne-komunen-e-prishtines> ). Çka vlen me cek si të arritur është që disa projekte të prezantuara në këtë union që kanë të bëjnë me digjitalizimin e shërbimeve me qytetarë janë marr si shembull ka Bashkia e Tiranës. Poashtu, pas themelimit të Unionit të Bashkëve Shqiptare është thellu bashkëpunimi mes Komunës së Prishtinës dhe asaj të Preshevës (Linku: <http://prishtinaonline.com/kerkimi/1212/thellohet-bashkepunimi-mes-komunes-se-prishtines-dhe-asaj-te-presheves> ). Në këtë takim u

				<p>diskutuan në detaje projektet që janë bërë në Administratën e Komunës së Prishtinës, projekte këto që kanë rezultuar shumë të suksesshme. Ndër temat e diskutimit ishin dixhitalizimi i shumë shërbimeve, menaxhimi i radhëve, e-Kiosku, e-Inspeksioni, dhe projekte të ngjashme që kanë ndikuar dukshëm në rritjen e cilësisë së shërbimeve ndaj qytetarëve.</p> <p>Komuna e Prishtinës është e gatshme që përvojën e vet në qeverisje të mirë ta shpërndajë sa më shumë në komunat shqiptare, në mënyrë që përmes projekteve që kanë rezultuar të suksesshme në Prishtinë të ndikojë në përmirësimin e cilësisë së jetës të qytetarëve në komunat tjera.</p>	
	<p><b>12.Kapitulli 28 i acquis-së: Mbrojtja e konsumatorit dhe e shëndetit publik</b></p>				

12.1.Mbrojtja e Shëndetit të Nënës, Fëmijës dhe Shëndetit Riprodhues

**Drejtoria e Administrates/Drejtoria e shëndetësis**

1. Sa trajnime ka organizuar komuna juaj për shëndetin e nënës dhe e fëmijës?
